


# KËRKESË



KËRKUES: Feruzan Durdaj, i biri i Veliut,  
i datëlindjes 1968, i lindur në Kotkë,  
Gramsh dhe banues në Marqinet, Vorë;

Zamira Durdaj, e bija e Hometit,  
e datëlindjes 1971, e lindur në Kotkë,  
Gramsh dhe banuese në Marqinet, Vorë.

OBJEKTI: Kërkesë për marrjen e masave për të siguruar gjykimin e shpejtë dhe mundësisht të pandërprerë.

DREJTUAR: Zëvendëskryetarit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

I nderuar Zv/Kryetar,

Që prej muajit Mars 2023 në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka nisur procesi penal në ngarkim të të pandehurit Fatmir Mediu për veprat penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, etj.

Së bashku me seancat paraprake, për një periudhë prej 16 muajsh janë zhvilluar 35 seanca gjyqësore, ku jo të gjitha kanë qenë efektive. Mesatarisht është zhvilluar një seancë çdo dy javë, në kufijtë maksimalë kohorë të parashikuar nga neni 342 i Kodit të Procedurës Penale, i cili shprehet:

*Neni 342*

*Gjykimi i pandërprerë*

- 1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një seancë të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.*
  - 2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në pesëmbëdhjetë ditë.*
- [...]*

Siç rezulton nga dispozita, shtyrja bëhet vetëm për arsye të veçanta dhe jo të shndërrohet në rregull. Deri më sot ka ndodhur shumë shpesh që shtyrjet kanë qenë me afate dy javore, ndërsa asnjëherë nuk ka vijuar gjykimi ditën e mëpasme të punës.

Trupi gjykues justifikohet me ngarkesën me gjykime të tjera, çka sipas gjykatës përbën shkak të vlefshëm për të shtyrë seancat në kufijtë maksimalë të ligjit.

Me qëllim që gjykimi ndaj shtetasit Fatmir Mediu të zhvillohet shpejt, për interesa të drejtësisë, të familjarëve të viktimave dhe të plagosurve të tragjedisë së Gërdecit që janë investuar në këtë

proces, si dhe të vetë të pandehurit, nevojitet që të gjenden mundësitë për të shmangur shkaqet që krijojnë vonesa.

Një nga zgjidhjet me vlerë do të ishte që gjyqtarja e çështjes, Znj. Irena Gjoka, të mos ngarkohet me çështje të tjera gjatë periudhës që është e angazhuar në këtë proces, deri në përfundimin e tij. Një zgjidhje e tillë është praktikuar edhe në gjykimin e 29 të pandehurve të tjerë për aferën dhe tragjedinë e Gërdecit, ku trupa gjyquese e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në vitet 2009-2012 u shmang nga ngarkesa të tjera dhe arriti të kryente rregullisht dy seanca në javë, për të arritur përfundimin e procesit për më pak se tre vjet.

Nëse në procesin aktual ndaj të pandehurit Fatmir Mediu, do të duhet një numër i njëjtë seancash si në rastin e 29 të pandehurve të tjerë, koha që do i duhej GJKKO me ritmet e sotme të seancave një herë në dy javë, do të ishte 4 herë më e gjatë se ajo që iu desh Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Që nga tragjedia tashmë kanë kaluar 16 vjet. Ky faktor shton domosdoshmërinë që të merren masa konkrete që drejtësia të mos jetë më shumë e vonuar se kaq, për të mos u shndërruar në një drejtësi iluzive dhe efektivisht të mohuar.

Me respekt,

Tiranë, më 26.06.2024

KËRKUESIT

Feruzan Durdaj

Zamira Durdaj

